| **Buletini Nr. 357/ 2024, 22-12-2024** | **Parashikimi** nga 22-12-2024, ora 12:00 deri 23-12-2024, ora 23:59. |
|---|---|

## DËBORA DHE NGRICA

----------------------------

Nesër (e hënë, dt. 23) reshjet e dëborës pritet të përfshijnë zonat Verilindore, Lindore dhe Juglindore të territorit. Reshjet e dëborës të pasuara nga ulja e ndjeshme e temperaturave dhe ngricat mund të krijojnë probleme të ndryshme dhe vështirësi në transportin rrugor.

## PARASHIKIMI METEO

----------------------

### RESHJET

Sot pasdite (e dielë, dt. 22) priten reshje të dobëta në të gjitha qarqet. Nesër (e hënë, dt. 23) priten reshje intensive deri lokalisht shumë intensive në qarqet Vlorë dhe Gjirokastër, reshje intensive në qarqet Shkodër, Kukës dhe Dibër ndërsa qarqet e tjerë priten reshje mesatare deri lokalisht intensive të shoqëruara me shtrëngata (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).
Në Veri, Lindje dhe Juglindje në lartësitë mbi 400 m nga niveli i detit reshjet do të jenë në formë dëbore.

Shtrëngatat dhe intensiteti i lartë i reshjeve, për momente të shkurtra, mund të krijojnë probleme të ndryshme, si dhe vërshime të ujit në zonat urbane, në varësi të sistemit të kanalizimeve në të gjitha qarqet**.**

### TEMPERATURA

Nesër (e hënë, dt. 23) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 7 / 13 °C ; në vendet e ulëta: 4 / 12 °C ; në vendet malore: -4 / 4 °C

### ERA

Sot pasdite (e dielë, dt. 22) dhe nesër (e hënë, dt. 23) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare, ndërsa në bregdet pritet të fryjë e fortë.

| ***NIVELET E RREZIKUT*** | **S'KA RREZIK** | **I ULËT** | **I MODERUAR** | **I LARTË** |
|---|---|---|---|---|

| **Buletini Nr. 357/ 2024, 22-12-2024** | **Parashikimi** nga 22-12-2024, ora 12:00 deri 23-12-2024, ora 23:59. |
|---|---|

## PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)

| RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT | Zjarre në pyje | Ngjarje Meteorologjike | | | Ngjarje Hidrologjike | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zjarret Mesatarja e qarkut | Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut | Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara | Shtrëngata | Përmbytje të Shpejta | Përmbytje Lumenjsh | Rrëshqitje toke |
| SHKODËR | S'KA RREZIK | intensive | | | | | |
| KUKËS | S'KA RREZIK | intensive | | | | | |
| DIBËR | S'KA RREZIK | intensive | | | | | |
| LEZHË | S'KA RREZIK | mesatare | intensive | | | | |
| DURRËS | S'KA RREZIK | mesatare | intensive | | | | |
| TIRANË | S'KA RREZIK | mesatare | intensive | | | | |
| ELBASAN | S'KA RREZIK | mesatare | intensive | | | | |
| FIER | S'KA RREZIK | mesatare | intensive | | | | |
| BERAT | S'KA RREZIK | mesatare | intensive | | | | |
| KORÇË | S'KA RREZIK | mesatare | intensive | | | | |
| VLORË | S'KA RREZIK | intensive | shumë intensive | | | | |
| GJIROKASTËR | S'KA RREZIK | intensive | shumë intensive | | | | |

## LEGJENDA: *Reshjet 24-orëshe*

| **Niveli i Rrezikut** | ***Reshje shiu*** (mm / 24 orë) |
|---|---|
| S'KA RREZIK | të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë)<br>Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I ULËT | mesatare (15 – 45 mm / 24 orë)<br>Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I MODERUAR | intensive (45 – 90 mm / 24 orë)<br>Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike. |
| I LARTË | shumë intensive (> 90 mm / 24 orë)<br>Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive. |

## LEGJENDA: *Zjarre në pyje*

| | |
|---|---|
| S'KA RREZIK | Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht. |
| ULËT | Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara. |
| I MODERUAR | Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme. |
| I LARTË | Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë. |




***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT***
***për sot dhe nesër, dt. 22–23.***

## *SIMBOLE*

| | |
|---|---|
|  | Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme |
|  | Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël |
|  | Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj |
|  | Rrëshqitje toke |